

**VENDIMI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
TE SHOQERISE "For Alb Alabaster" Sh.p.k**




Sot me dt. 26.05.2006 Ortaket e shoqerise "For Alba Alabaster" shpk, Z. Enea Leoncini ortaku italian dhe perfaqesuesi i ortakut shteteror, Z. Vaso Pano, I cili ka cilesine e perfaqesuesit ne baze te urdherit nr.392 dt.26.05.2006 te leshuar nga Ministri I Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes Z. Genc Ruli, ne perputhje me kompetencat qe ka ne statutin dhe aktin e themelimit te kesaj shoqeri, dhe ne zbatimin e ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare", Ligjit nr. 8885 dt. 22.04.2002, ne prani te noteres Tamara Malaj zhvilluan mbledhjen e jashtezakonshme te asamblese se ortakeve, sipas rendit te dites se njoftuar me pare dhe ne perfundim:

VENDOSI

1. **Pranimin e perfaqesuesit te ri te ortakut shtet Z. Vasil Pano**, ne baze te Urdherit nr. 392 dt. 26.05.2006 leshuar nga Ministri i **Ministrise se Ekonomise, e Tregetise dhe Energjitikes, Z. Genc Ruli.**
2. **Z. Enea Leoncini,ri emerohet** ne cilesine e administratorit te ri te shoqerise **For Alb Alabaster.**
3. Te miratoje ndryshimet e nenit 19 te satutit i cili behet: *Aktiviteti i shoqerise zgjat 20 vjet duke filluar nga data e ndryshimit ne Gjykate, sipas propozimit te bere nga nje prej ortakeve te aprovuar nga Asambleja e ortakeve me shumicen e parashikuar ne nenin 7638 dt, 19.11.1992*
si dhe nenin 2 te kontrates te themelimit te shoqerise i cili behet:
Shoqeria do ta kene seline e saj ne Mengaj -Kavaje
Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per 20 (njetzet) vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit ne Regjistrin tregetar te ketij ndryshimi, ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.
4. Ngarkohet Z. Enea Leoncini te paraqese kerkesen per ndryshimet perkatese ne Gjykate.

Ortaku Italian

Enea LEONCINI



Enea LEONCINI

Perfaqesuesi i
Ortakut shtet "Ministria e Ekonomise, e
Tregetise dhe Energjitikes

Vasil PANO



VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

"Foralb Albastër" SH.P.K.

Datë: 04 Maj 2017

Sot më datë 04.05.2017, e enjte ora 10.30, u mbledh asambleja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Foralb Albastër" sh.p.k., e cila mbahet pranë ambienteve të shoqërisë, vend ky i njoftuar rregullisht në aktin e njoftimit të mbledhjes së asamblesë. Kjo mbledhje u mbajt në vijim të njoftimit për thirrjen e Asamblese së Ortakëve nga administratori i shoqërisë në datën 21 Prill 2017 protokolluar pranë Ministrisë së Zhvillimit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes me Nr. 4103 Prot, dt 21/04/2017 dhe njoftuar dhe nëshkruar nga ortakun tjetër Alesio- 2014 shpk po në të njëjtën datë. Shoqëri kjo e regjistruar në Shqipëri, me seli në Mengaj, Kavajë me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm NIPT: J62903844I

Asambleja e Ortakëve përbëhet nga

Enea Leoncini i paisur me kart identiteti nr. A006796658, që zotëron 29.99% të kuotave të shoqërisë

Alesio-2014 shpk me NIPT L41713003M përfaqësuar nga administratori ligjor Anton Gjinaj me kartë identiteti G60408041I, i cili zotëron 45% të kuotave të shoqërisë

Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, si ortak i 25% të kuotave përfaqësuar të cilët nuk u paraqitën në mbledhje e asamblesë

Me cilësinë e mbajtjes së proces verbalit dhe përkthyeses Znj. Albana Ahmeti e paisur me pasaporte me BA3368434

Mbledhja mbahet në selinë e shoqërisë, vend ky i njoftuar rregullisht në aktin e njoftimit të mbledhjes së asamblesë, nga ortaku Enea Leoncini. Axhenda e mbledhjes është:

- Miratimin e Bilancit kontabel të vitit 2016
- Miratimin e emërimit të administratorit Enea Leoncini deri më 17 Maj 2022, duke filluar nga 17 Maj 2017

Në mbledhje morën pjesë Enea Leoncini i cili zotëron 24.99% të kuotave të shoqërisë dhe **Alesio-2014 shpk** me NIPT L41713003M përfaqësuar nga administratori ligjor Anton Gjinaj me kartë identiteti G60408041I, i cili zotëron 45% të kuotave të shoqërisë dhe **Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes**, si ortak i 25% të kuotave përfaqësuar

Ortakët diskutuan dhe

VENDOSËN:

- Miratimin e Bilancit kontabel të vitit 2016. Fitimi i vitit ushtrimor prej 154 718 (njëqind epesëdhjetëekatërmijeshatëqindetëmbëdhjetë) të përdoret për mbulimin e pjesës së humbjes së mbartur. Pjesa tjetër e humbjes prej 86 164 të mbartet në bilancin e vitit 2017.
- Miraton pikën 2 të rendit të ditës "Emërimin e Z. Enea Leoncini" si administrator të shoqërisë duke filluar nga data 17 Maj 2017 deri në 17 Maj 2022.
- Enea Leoncini autorizohet dhe ngarkohet të depozitojë kopje të këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas rregullave në fuqi dhe deklarimin në sistemin e tatimeve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


ORTAKËT

Ortaku Italian


Perfaqesuesi i Ortakut shtet

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Siper marrjes

Enea LEONCINI





Znj. Gjinovefa ARIZAJ



Ortaku


Alesio-2014 shpk

Anton Gjinaj



Mbajtesja e proces-verbalit te mbledhjes dhe perkthyesja

Albana Ahmeti



VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

"Foralb Albastër" SH.P.K.

Datë: 29 Janar 2019

Sot më datë 29.01.2019, ora 11.00, u mbledh asambleja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Foralb Albastër" sh.p.k., e cila mbahet pranë ambienteve të shoqërisë, vend ky i njoftuar rregullisht në aktin e njoftimit të mbledhjes së asamblesë. Kjo mbledhje u mbajt në vijim të njoftimit për thirrjen e Asamblese së Ortakëve nga administratori i shoqërisë në datën 22 Janar 2019 protokolluar pranë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë me Nr.1019 Prot, dt 22/01/2019 dhe njoftuar dhe nëshkruar nga ortakun tjetër Alesio- 2014 shpk po në të njëjtën datë. Shoqëri kjo e regjistruar në Shqipëri, me seli në Mengaj, Kavajë me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm NIPT: J62903844I

Asambleja e Ortakëve përbëhet nga:

Alesio-2014 shpk me NIPT L41713003M përfaqësuar nga administratori ligjor Anton Gjinaj me kartë identiteti G60408041I, i cili zotëron 74.99% të kuotave të shoqërisë

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, si ortak i 25% të kuotave, **përfaqësuesit të cilët nuk u paraqitën në mbledhje e asamblese**

Me cilësinë e administartorit të shoqërisë është paraqitur Enea Leoncini i paisur me kart identiteti nr. AY 0868826

Me cilësinë e mbajtjes së proces verbalit dhe përkthyeses Znj Denisa Bozili identifikuar me id karte nr. personal I96101027P.

Mbledhja mbahet në selinë e shoqërisë, vend ky i njoftuar rregullisht në aktin e njoftimit të mbledhjes së asamblesë, nga administratori Enea Leoncini, Axhenda e mbledhjes është:

1. Miratimin e doreheqjes se administratorit Enea Leoncini
2. Emërimin e administratorit të ri Z. Anton Gjinaj
3. Të tjera

Në mbledhje mori pjesë vetwm **Alesio-2014 shpk** me NIPT **L41713003M** përfaqësuar nga administratori ligjor Anton Gjinaj me kartë identiteti G60408041I, i cili zotëron 74.99% të kuotave të shoqërisë dhe **Ministria e Financave dhe e Ekonomisë**, si ortak i 25% të kuotave nuk u paraqit.

Ortakët diskutuan dhe

V E N D O S Ë N:

1. Miratimin e doreheqjes se administratorit Enea Leoncini
2. Emërimin e administratorit të ri Z. Anton Gjinaj me afat nga data 29 Janar 2019 deri më 29 Janar 2024
3. Znj Denisa Bozili identifikuar me id karte nr. personal I96101027P, autorizohet dhe ngarkohet të depozitojë kopje të këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas rregullave në fuqi .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKËT

Në perfundim ortaku i maxhorances e deklaroi të mbyllur asamblenë.

Alesio 2014 shpk

Perfaqësuesi ligjor

Anton Gjinaj

Anton Gjinaj


Perfaqësuesi i Ortakut shtet

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë

Znj. Gjinovefa ARIZAJ

Nuk u paraqit

Mbajtësja e proces-verbalit të mbledhjes ,vendimit të asamblese dhe perkthyesja

Denisa Bozili

Denisa Bozili
